

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SPAK aksion në Shkodër e Tiranë/ Goditet grupi kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Dokl en, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/spak-operacion-ne-shkoder-e-tirane-goditet-nje-grup-inal-i-traf-i516133
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 10:16:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 10:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8096f695ee873814d886df7c5a743f2c91781af377ff02980348321df6e00c85
TEKSTI	a55edc1dd65387fa2a3df8a2a8155ffeb2caf6548dc8f7e0b0a47ee2f7fa6366
PAMJA	1f9f593d542364c2033671b4005d9336bded73a2d508d70bda75aa0519adb051

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1d39aa4907173c37031e49dc4e286a9af77d73172c0d05158f7bc20c6b69c018
E MËPARSHMJA	ce7e08b8fe125ccb4e54dd660db88841d4b73bcd2a0a400263ac48401b2705b4
RRËNJA MERKLE	2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/1d39aa4907173c37031e49dc4e286a9af77d73172c0d05158f7bc20c6b69c018

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

11 MINUTA ME PARE

Zyrtarisht në detyrë/ Eric Wendt dorëzon letrat kredenciale, nis misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri

30 MINUTA ME PARE

SPAK aksion në Shkodër e Tiranë/ Goditet grupi kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)

16 ORE ME PARE

"Shqipëria po përjeton të ardhmen që të tjerët ende po e diskutojnë"/ Rama nga OKB: Algoritmi aktivizoi urrejtjen, qytetarët protestuan kundër një armiku imagjinar izraelit

17 ORE ME PARE

Dita e 118-të e protestës/ Qytetarët zbrisin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

LIVE UPDATES

SPAK aksion në Shkodër e Tiranë/ Goditet grupi kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)

• Policia e Shtetit dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, nën drejtimin e SPAK, kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Muri i Lartë". • Në kuadër të këtij operacioni është vënë në pranga janë caktuar dy masa sigurie, ndërsa një prej tyre është ekzekutuar në Shkodër. • Bëhet me dije se gjatë operacionit është vënë në pranga 50-vjeçari Bledar Çafi. • Kapja dhe arrestimi i tij u bë në orët e para të mëngjesit të sotëm, në banesën e tij në Shkodër. • Gjykata e Posaçme ka caktuar ndaj tij "Arrest me burg" për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike", kryer në bashkëpunim, në formë të grupit të strukturuar kriminal, si dhe "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal". • Po ashtu është lëshuar urdhërarrest për Indrit Doklen, një emër i shumëpërfolur i botës së krimit dhe ish-anëtar i bandës së Durrësit. Dokle është shpallur sërish në kërkim me urdhër të SPAK i akuzuar për trafik droge si pjesë e grupit të 'Rrajave'. • Masa e sigurisë "arrest me burg" ndaj Dokles u caktua një ditë më parë me vendim të GJKKO-së. Gjatë operacionit janë ushtruar kontrolle në vendet që i përkasin Indrit Dokles, por ish-anëtar i bandës së Durrësit nuk u gjet aty.

4 artikuj për këtë temë.

1 ORE ME PARE

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtar i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës



TIRANË- SPAK ka lëshuar për herë të parë urdhërarrest për ish-anëtarin e Bandës së Durrësit, Endrit (Indrit) Dokle, i akuzuar si pjesë e një grupi kriminal të trafikut të drogës. Me urdhër të SPAK u ushtruan kontrolle në disa ambiente në pronësi të Dokles, por ai nuk u gjet aty. Indrit Dokle deri më tani ishte shfaqur në dosjet e SPAK si objekt i planeve për

editoriale

Auron Janku

"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Në vëmendje

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:36

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtar i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës



eliminimin e tij.

Po kush është Endrit Dokle?

Endrit Dokle, anëtar i “Bandës së Durrësit”, ishte akuzuar së bashku me 16 persona të tjerë, si pjesë e bandës famëkeqe, ku disa prej tyre janë dënuar për vrasje, plagosje, atentate, rrëmbime, trafik droge e qenie njerëzore. Ai ka drejtuar një prej fraksioneve të bandës dhe me Lulzim Berishën, njeriun që sipas Prokurorisë e krijoi atë, pati një armiqësi të hapur për vite me radhë, madje tentoi edhe ekzekutimin e tij. E ashtuquajtura “banda kriminale”, me drejtues të përbashkët Lulzim Berishën dhe Klodian Saliun, funksiononte prej vitit 1994 në qytetin e Durrësit.

Si pjesë e Bandës së Durrësit, Indrit Dokle ishte dënuar me burgim të përjetshëm për krimet e kryera, por në janar 2020 fitoi lirinë me vendim të gjyqtarsë së Krujës, Enkelejda Hoxha. Ajo i shuajti dënimin e përjetshëm duke e konvertuar në 25 vite burg dhe më pas e liroi me kusht, duke i kaluar 5 vitet e mbetura në shërbim prove. Dokle kishte qëndruar në qeli që prej vitit 2005. Prokuroria e Krujës e ankimoi vendimin, duke argumentuar se Dokle është një përsëritës krimesh dhe nuk plotësonte kushtet ligjore për lirinë me kusht, por kërkesa është ende në Apel dhe nuk është caktuar ende data për shqyrtimin e saj.

Si u bë Indrit Dokle armiku i Lul Berishës?

Adriatik Coli, rrëfeu para gjykatës në vitin 2009, se për vrasjen e Lul Berishës, ata donin të pajtonin Emiljano Shullazin dhe Dritan Dajtin, por të dy, kërkuar 200 mijë euro. Krisja e parë e bandës ndodh kur Lul Berisha i kthen shpinën Klodian Saliut në vrasjen Marsel Sotirës, i cili u nxorr në pritë nga “Miss Skrapari”.

Por anëtarët e bandës, Indrit Taullai dhe Klodian Saliu, zbuluan se Lul Berisha iu kishte zbuluar krahët. Adriatik Coli rrëfen: “Ata thanë: Si na e bëri Luli këtë gjë. Kështu që kur kthehem nga Italia, Klodi kthehet në Qershor të vitit 2000, më thërret te shtëpia. U futëm te kuzhina dhe më pyet për ngjarjen e Marsel Sotirit si ndodhi që iket dhe unë i shpjegova. Klodi bindet që ja kishin me të futur Lul Berisha dhe Plaurenti...”.

Kështu, në vitin 2003, banda u nda në dy celula të ndara nga njëra-tjetra të cilat filluan të funksionojnë të ndara, për hesap të Lul Berishës dhe Klodian Saliut. Saliu dhe Lul Berisha porositën 15 kilogramë, për të cilën kishin bashkuar paratë për ta blerë tek dy turq. Nga porosia që erdhi, u pa se vetëm 3.5 kilogram heroinë ishte e pastër, ndërsa pjesa tjetër ishte zhavorr. Atë që erdhi e mori Klodi, ndërsa lekët e Lul Berishës shkuan kot, duke sjellë edhe prishjen mes tyre.

Përplasjet në dukje të vogla kulmuan kur pas liritimit nga burgu të Klodian Saliut, ai kishte krijuar grupin e tij të ndarë nga Lul Berisha. Indrit Taullai, Julian Meçe, dhe Plaurant Dervishaj, ishin pjesë e grupit të Lul Berishës ndërsa Adriatik Coli dhe Indrit Dokle, pjesë e grupit të Klodian Saliut. Edhe pse dikur e kishte kapo, Dokle nuk e honepste dot Lul Berishën. Ndërsa Berisha i cilësonte Indrit Doklen dhe shokët e tij “kalamaj”. Kjo solli acarimin e Klodian Saliut, ndërkohë që grupi ishte ndarë tashmë, dhe siç thoshte Shkëlqim Saliu “ata çuna nuk ishin kalamaj, por burra që i kishin lyer duart me gjak”.

Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar

Në dosjen “Plumbi i Artë”, i penduari i drejtësisë Nuredin Dumanit ka dëshmuar se Ervis Martinaj, i zhdukur prej gushtit 2022, i kishte ofruar 500 mijë euro për vrasjen e Dokles, nga të cilat pretendonte se kishte marrë 100 mijë euro parapagim. Pas zhdukjes së Ervis Martinajt në gusht të vitit 2022, Dokle u mor në pyetje nga hetuesit.

Familjarët e Martinajt kishin kërkuar të hetohej edhe pista e një hakmarrjeje të mundshme nga Dokle, nisur nga pretendimi i Dumanit se Martinaj kishte porositur vrasjen e tij. Emri i Dokles doli edhe në një tjetër procedim të SPAK. Më 2 qershor 2026, GJKKO dënoi Elvin Merlikën dhe Alket Xhixhën për sigurimin e kushteve për vrasjen e tij, në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Aksioni i SPAK kundër grupit Rraja/ Shkon në 17 numri i të dyshuarve, Indrit Dokle i akuzuar për trafik ndërkombëtar droge



AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:14

U arrestua nga SPAK gjatë operacionit “Muri i Lartë”/ Kush është Bledar Çafi, “i forti” i Shkodrës ndër vite i përfshirë në botën e krimit



AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 10:55

VIDEO/ Operacioni i SPAK në Shkodër, momenti i arrestimit të 50-vjeçarit me rrezikshmëri të lartë, Bledar Çafi

më të klikuarat

VIDEO/ Pamje të rënda nga atentati në Sarandë! Artan Myrtaj vrapon për tu shpëtuar plumbave, autorët e ndjekin dhe qëllojnë në mes të rrugës

Vrasja e ‘Tanit të Rruzdiut’ në Sarandë, dalin fotot e autorit në momentin e ekzekutimit

Nga karriera e gjatë diplomatike dhe ushtarake tek posti si ambasador në Shqipëri/ Gazeta amerikane: Eric Wendt vjen në Tiranë mes protestave masive kundër qeverisë

Këshilli Bashkiak i Tiranës kërkon Erion Veliajn në mbledhje, kërkesë SPAK-ut: Nëse nuk është e mundur fizikisht të lejohet online

insights

Bledian Koka
I vetmi
Kryeminister!

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në
kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim
po ndërtohet një
pallat

Auron Janku
Kur PARTITË
harrojnë pse
ekzistojnë

Indrit Dokle

Moti

Powered by tomorrow

SHKODËR- Detaje të reja janë zbardhur nga operacioni “Muri i Lartë”, ku hetimet e ndjekura nga prokurori i SPAK Adnand Xholi, kanë zbuluar lidhje të ngushta me grupin kriminal të Rrajave. Me lëshimin e urdhërarresteve të fundit ndaj Bledar Çafit dhe Indrit Dokles, numri i të dyshuarve që përballen me masa sigurie në këtë dosje ka arritur në 17 persona.

Në kuadër të këtij procedimi penal, Gjykata e Posaçme ka firmosur një masë të re sigurie “Arrest me burg” për shtetasin Endrit (Indrit) Dokle. Ndaj tij janë ngritur akuza për trafik ndërkombëtar të kokainës. Dokle nuk u gjet gjatë kontrolleve të ushtruara në banesën e tij gjatë operacionit “Muri i Lartë”.

Hetimet e udhëhequra nga prokurori Xholi kanë dokumentuar aktivitetin e grupit të Rrajave në trafikun e lëndëve narkotike dhe veprat e lidhura me krimin e organizuar. Përfshirja e emrave si Bledar Cafi, i arrestuar në Shkodër, dhe Indrit Dokle tregon për shtrirjen e këtij rrjeti në disa qarqe të vendit dhe jashtë tij./Dosja.al

1 ORE ME PARE

U arrestua nga SPAK gjatë operacionit “Muri i Lartë”/ Kush është Bledar Çafi, “i forti” i Shkodrës ndër vite i përfshirë në botën e krimit



pamjet nga arrestimi

SHKODËR- 50-vjeçari Bledar Çafi u arrestua gjatë operacionit të koduar “Muri i Lartë”, të zhvilluar nga Policia e Shtetit, BKH-ja dhe strukturat e tjera operationale, nën drejtimin e SPAK. Çafi i njohur ndryshe edhe si “i forti” i Shkodrës” u kap në banesën e tij në orët e para të mëngjesit.

Ndaj tij GJKKO me vendim të datës 25 shtator 2026, kishte caktuar masën e sigurisë “arrest me burg” për veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, si dhe akuza të tjera që lidhen me veprimtarinë e grupit.




Çafi është dënuar më parë për trafik droge dhe pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal. Më datë 4 qershor të 2020,

Gjykata e Triestes në Itali e dënoi Çafin me 4 vite dhe 2 muaj burg për trafik droge në sasi të mëdha.

“I forti” i Shkodrës” është përmendur në ngjarje të rënda kriminale në qytetin e Shkodrës, përfshirë dyshime apo akuza për gjakmarrjeje e vrasjeje, për të cilat nuk ka rezultuar gjithmonë i dënuar për mungesë provash Çafi përfshirjes në botën e krimit, 50-vjeçari dhe familja e tij kanë zotëruar ose administruar biznese të ndryshme në Shkodër, si njësi tregtare, bar-kafe dhe aktivitete tregtimi./Dosja.al

2 ORE ME PARE

SPAK operacion në Shkodër e Tiranë/ Goditet një grup kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)



TIRANË- Policia e Shtetit dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, nën drejtimin e SPAK, kanë finalizuar operacionin policor të koduar “Muri i Lartë”. Në kuadër të këtij operacioni është vënë në pranga janë caktuar dy masa sigurie, ndërsa një prej tyre është ekzekutuar në Shkodër.

Bëhet me dije se gjatë operacionit është vënë në pranga 50-vjeçari Bledar Çafi. Kapja dhe arrestimi i tij u bë në orët e para të mëngjesit të sotëm, në banesën e tij në Shkodër.

Gjykata e Posaçme ka caktuar ndaj tij “Arrest me burg” për veprat penale “Trafikim i lëndëve narkotike”, kryer në bashkëpunim, në formë të grupit të strukturuar kriminal, si dhe “Grup i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.

Po ashtu është lëshuar urdhërarrest për Indrit Doklen. Në zbatim të vendimit të GJKKO-së, u ushtrua kontroll në vendet që i përkasin Indrit Dokles lindur në Kukës dhe banues në Tiranë.

43-vjeçari është në kërkim që prej vitit 2024, pasi GJKKO ka caktuar ndaj tij masën e sigurisë “Arrest me burg” për veprat penale “Trafikim i lëndëve narkotike”, kryer në bashkëpunim, në formë të grupit të strukturuar kriminal, si dhe “Grup i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.



Njoftimi:

Finalizohet operacioni policor i koduar "Muri i Lartë". Operacioni nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me BKH-në, nën drejtimin e SPAK. Kapet dhe vihet në pranga një shtetas me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Vijon puna për kapjen e një shtetasi tjetër, i cili gjatë operacionit nuk u gjet në banesë.

Strukturat operationale dhe hetimore të Policisë së Shtetit, konkretisht Forcat Speciale Renea, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operationale, Drejtoria për Hetimin e Narkotikëve, DVP Shkodër dhe BKH, nën drejtimin e SPAK, në zbatim të urdhrit të Prokurorisë së Posaçme SPAK dhe të vendimit të Gjykatës, kanë zhvilluar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Muri i Lartë", me qëllim ekzekutimin e masës së sigurimit personal ndaj një shtetasi, si dhe kryerjen e kontrolleve për lokalizimin dhe kapjen e një shtetasi tjetër, i shpallur në kërkim.

Në kuadër të operacionit, në Shkodër u bë e mundur kapja dhe arrestimi i shtetasit B. C., 50 vjeç, lindur dhe banues në Shkodër, person me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Kapja dhe arrestimi i tij u bë në orët e para të mënjajesit të sotëm, në banesën e tij në Shkodër. Givkata e Posaçme e Shkallës

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.